



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës, Nr. 04/L-076, Rregulloren (MPB) Nr.02/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës neni 26, si dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 19/08/2025 me nr ref: DBN 10/1-01/107/2025, Policia e Kosovës shpall:

K O N K U R S

Datë: 22.08.2025

Referenca: 10/1-01/SRS/0404/2025

Për plotësimin e vendit të punës

1. **Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist_ mjekësisë së punës një (1) vend i lirë pune**

Vendi i punës: Sektori i Mjekësisë dhe Promovimit të Shëndetit /Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/ Divizioni i Personelit dhe Administratës / Departamenti i Burimeve Njerëzore

Klasa: H8

Koeficienti: 12

Për vitin 2025 zbatohet ligji për ndarjen buxhetore nr. 08/L-332 neni 33 paragrafi 1 dhe 2.

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të pa caktuar

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë ekzaminime mjekësore fizike, përdorë mjetet e punës specifike, vendos diagnozën e punës, referon për analiza, hulumtime diagnostike dhe konsulta specializimi, këshilla profesionale për pacientin;
- Plotëson kartelën shëndetësore;
- Bënë promovimin shëndetësor, parandalimin, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve;
- Bënë vlerësimin e aftësisë për punë në Policinë e Kosovës;
- Angazhohet në Urdhra Operative;

- Ofron përkrahje profesionale për Personelin e PK-së me probleme shëndetësore në spital dhe në QKUK;
- Merr pjesë ekzaminime mjekësore sistematike dhe kontrolla mjekësore të regrutëve të rinjë;
- Shqyrton lëndë dhe kërkesa të ndryshme, që kanë të bëjnë me aftësinë për punë dhe profesionin në aspektin shëndetësor;
- Është përgjegjësi dhe detyrë që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të angazhohet në mbledhjen e informatave të inteligjencës nga të gjitha burimet në dispozicion;
- Kryen edhe punë tjera që ia përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe dhe të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.

Shkollimi i kërkuar dhe shkathtësitë:

- Të posedoj diplomën e fakultetit të mjekësisë dhe certifikatën e specializimit Mjekësi e Punës;
- Licenca e punës lëmia përkatëse –valide;
- Aftësi profesionale të punojnë në mënyrë të pavarur;
- Aftësi të punojë në situatë emergjente;
- Aftësi të punojë në ekip të shumëllojshëm;
- Shkathtësi të mira ndër personale;
- Të ketë shkathtësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Patentë shofer valid dhe aftësi të ngasë veturën;
- Njohuri të programeve të Microsoft Office: Word, Excel, PowerPoint, Outlook, Project etj.
- Dëshmi mbi njohurit e përdorimit të echo aparatit (ultrazërit) – e dëshirueshme;
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi, që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.

Kërkesat e përgjithshme për pranim janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës,
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike,
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimi.

Forma e aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. Aplikimi online ose
2. Aplikimi në formë fizike.

1. **Aplikimi online** bëhet përmes ueb faqes zyrtare të PK-së:
www.kosovopolic.com/ Shpallje/ Mundësi punësimi.

Në aplikimin online duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
 - b) Kopja e certifikatës së specializimit Mjekësi e Punës
 - c) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
 - d) Kopja e patentë shoferit;
 - e) Kopja e licencës së punës, lëmi përkatëse-valide;
 - f) Dëshmi mbi njohurit e përdorimit të echo aparatit (ultrazërit) – e dëshirueshme;
 - g) Certifikata e Gjendjes Penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
 - h) Një fotografi të formatit (5 x 5);
2. **Aplikimi në formë fizike** - Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Në aplikimin në formë fizike duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Formulari për aplikim se bashku me Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com;
- b) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
- c) Kopja e certifikatës së specializimit Mjekësi e Punës
- d) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- e) Kopja e patentë shoferit;
- f) Kopja e licencës së punës, lëmi përkatëse-valide;
- g) Dëshmi mbi njohurit e përdorimit të echo aparatit (ultrazërit) – e dëshirueshme;
- h) Çertifikata /ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj);
- i) Çertifikata e gjendjes penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- j) Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- k) Një fotografi të formatit (5 x 5);

Formularët duhet t'i dorëzohen në Sektorin për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet.

Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim do t'i nënshtrohen intervistës. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Kandidatët të cilët kanë ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit, kanë të drejtë të ankohen.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo faze të testimit do të behet përmes publikimit të listave në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data 22.08.2025 deri me 05.09.2025.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751dhe 038 245 184 si dhe në adresën elektronike rekrutimi@kosovopolic.com.

“Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe personat me aftësi të kufizuar”.